zienda sociale, di rami di essa ovvero anche di singoli beni e diritti e blocchi di essi; gli atti necessari per la conservazione del valore dell'impresa, ivi compreso il suo esercizio provvisorio, anche di singoli rami, in funzione del miglior realizzo.

3. L'assemblea può sempre modificare, con la stessa maggioranza di cui al primo comma, le deliberazioni di cui al comma precedente.

Art. 31) LIQUIDAZIONE - 1. Alla fase di liquidazione della società si applicano le disposizioni degli articoli 2484 e ss. del codice civile.

2. Alla denominazione sociale deve essere aggiunta l'indicazione che trattasi di società in liquidazione.

3. La società può in ogni momento revocare lo stato di liquidazione, occorrendo previa eliminazione della causa di scioglimento, con deliberazione dell'assemblea dei soci, adottata con la stessa maggioranza di cui al primo comma dell'articolo precedente, con gli effetti di cui all'art. 2487-ter del codice civile.

#### TITOLO VIII: CLAUSOLA COMPROMISSORIA

Art. 32) ARBITRO - 1. Tutte le controversie che dovessero insorgere tra i soci nonché tra società e soci in relazione al rapporto sociale o all'interpretazione e all'esecuzione del presente statuto e delle deliberazioni legalmente adottate dagli organi sociali, quelle promosse da amministrato-

ri, liquidatori e sindaci ovvero nei loro confronti, purché compromissibili, verranno deferite a un Arbitro Unico nominato dal Presidente del Tribunale della Circostrizione in cui ha sede la società.

2. Non possono essere oggetto di clausola compromissoria le controversie nelle quali la legge preveda l'intervento obbligatorio del pubblico ministero.

3. L'Arbitro giudicherà secondo equità e senza formalità e il suo giudizio sarà inappellabile, salvo quanto disposto dal D.LGS. 17 gennaio 2003, n. 5 e sue eventuali modifiche ed integrazioni.

#### TITOLO IX: DISPOSIZIONI GENERALI

Art. 33) COMUNICAZIONI - Le comunicazioni da effettuare mediante raccomandata a.r. possono essere effettuate, in forma equivalente, anche mediante raccomandata a mani consegnata a soci, amministratori, sindaci, revisore e liquidatori e sottoscritta in calce dagli stessi per ricevuta.

Art. 34) RINVIO - Per quanto non espressamente contemplato nel presente statuto, si fa riferimento alle disposizioni contenute nel codice civile e nelle altre leggi vigenti in materia.

Firmato: ARDUINI ROBERTO

Vincenzo Galeota Notaio



4-11-2016 4252

4-11-2016

NOTAIO

*Vincenzo Galeota*

# APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

- 1. Stato: ITALIA.....
- Il presente atto pubblico
- 2. è stato firmato da GALEOTA VINCENZO.....
- 3. nella sua qualità di NOTAIO.....
- 4. porta il sigillo/timbro di GALEOTA VINCENZO.....  
 EUNARIO NOTAIO IN CARUGLIA.....  
 CONT. STEFANIA.....

- 5. a CARUGLIA ..... b. il 26/06/2017.....
- Il Sost. Procuratore della Repubblica
- 7. da .....  
 Sost. Procuratore della Repubblica
- 8. al N° 157/2017.....

9. Sigillo/Timbro

10. Firma  
Il Sost. Procuratore della Repubblica

PROÇES VERBAL I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË  
"SERVIZI GEOTECNICI" – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

REPUBLIKA ITALIANE

Në vitin dymijë e gjashtëmbëdhjetë  
Në datën shtatëmbëdhjetë të muajit tetor

17 tetor 2016

Në L'Aquila, Via Amleto Cencioni, nr. 5, pranë studios sime, në orën 11,00 (njëmbëdhjetë)  
Me kërkesë të "SERVIZI GEOTECNICI – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" me seli në L'Aquila, Lokaliteti  
Boschetto di Pile snc, pranë Tecnopolo D'Abbruzzo, kapitali themeltar prej euro 10.200,00 i derdhur i tëri,  
kodi fiskal dhe numri i regjistrimit në regjistrin e Ndërmarrjeve të L'Aquila 01522170669, unë i  
nënshkruari dr. Vincenzo Galeota, noter në L'Aquila, i regjistruar në Rolin e Rretheve të Noterëve të  
bashkuar të L'Aquila, Sulmona dhe Avezzanos, ka marrë pjesë sot, në mënyrë hartuar proces verbalin, në  
asamblenë e jashtëzakonshme të shoqërisë kërkuese, të thirrur në këtë vend, në orën e paraqitur më sipër,  
sipas marrëveshjeve mes pjesëmarrësve për të diskutuar dhe për të vendosur për të mëposhtmin:

REND TË DITËS

- 1) Përditësimi i statutit dhe zgjerimi i objektit të shoqërisë
- 2) Të ndryshme dhe të mundshme

E merr drejtimin e asamblesë, në bazë të statutit të shoqërisë zori ROBERTO ARDUINI, lindur në L'Aquila  
më 31 mars 1956, dhe me vendbanim për detyrën si më sipër, Administrator i Vetëm i Shoqërisë, për  
identitetin persona të të cilit unë Noteri jam i sigurt.

Ai, pasi konstatoi që përveç tij Administrator i Vetëm është i pranishëm i gjithë kapitali i shoqërisë që i  
takon për një kuotë prej euro 3.400,00 secilit prej tyre vetë administratorit dhe zotërinjve Massimo Orsini  
dhe Giuseppe Maria Ricci, siç rezulton nga fleta e prezencave të ruajtura në akte, e deklaroi këtë asamble  
të mbledhur në mënyrë të vlefshme sepse totalitare dhe më fton mua noterin që të marr funksionet e  
Sekretarit.

Pasi hapet diskutimi për pikën e parë në rend të ditës Kryetari i bën me dije pjesëmarrësve që në rast  
zgjerimi të objektit të shoqërisë është e nevojshme të procedohet me përgatitjen e një statuti të ri që të  
përfshijë, përveç parashikimeve kryesore që ekziston aktualisht por edhe përshtatsjet me normativën më të  
fundit për shoqëritë si ndër të tjera krijimi i Ekspertit Kontabël të Miratuar të Vetëm dhe një klauzolë  
kompromisi në përputhje me sa diktohet nga normativat në fuqi. Gjithashtu Kryetari propozon, me qëllim  
për të zgjeruar më tej aktivitetin e shoqërisë, që t'i japë mundësi asaj, nëpërmjet integritit të objektit, të  
organizojë dhe të administrojë edhe laboratorët dhe strukturat për bërjen e kolaudimeve dhe analizave  
teknike të produkteve dhe në veçanti thjesht si shembull të bëjë aktivitete në lidhje me kolaudimet fizike,  
kimike dhe të ndonjë lloji tjetër për materialet dhe produktet, ndër të cilët: provën e akustikës dhe të



vibracioneve, testimin për përbërjen dhe për pastërtinë e mineraleve dhe të materialeve të tjera, analizën e karakteristikave, të vetive fizike dhe të shërbimeve të materialeve, si rezistenca, trashësia, kohëzgjatja, radioaktiviteti etj., testimin e kualifikimit dhe të besueshmërisë, testimin e shërbimeve të makinerive të gatshme: motorëve, automobilave dhe pajisjeve elektronike, analizat radiografike të saldimit dhe të bashkimeve, analizat e difekteve, analizat dhe matjet e treguesve ambientalë: ndotësve atmosferikë dhe hidrikë, testimet e bëra me anë të përdorimit të modeleve (shembull; avionët, anijet, digat), dhe aktivitetet e suportit të laboratorëve të policisë shkencore.

Duke vazhduar kryetari propozon gjithashtu që të eliminojë selinë dytësore në Romë, Lungotevere Portuense, duke mos e konsideruar më të nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

Për këtë qëllim kryetari fton pjesëmarrësit që të shohin një draft të statutit të ri, të përgatitur në përputhje me normativën në fuqi, por në të cilin rezultojnë të përfshira dispozitat kryesore të statutit ekzistues, si objekti, përfshirë zgjerimin e parashikuar, selinë, kohëzgjatjen, sistemin e administrimit dhe përcaktimin e tagrave të administratorve.

Për këtë asambleja procedon me një analizë të kujdesshme të neneve të veçanta që përbëjnë tekstin e ri të përmendur të statutit dhe pas një diskutimi të shkurtër të përqëndruar kryesisht në klauzolat për të cilat ligji parashikon anashkalimin në krahasim me normativën, për mundësinë për të zgjeruar objektin e shoqërisë, në unanimitet vendos të miratojë, pa rezerva, tekstin e vetë statutit, të përbërë nga numër 34 (tridhjetë e katër) nene dhe që me leximin paraprak që ju bë nga unë të paraqiturit, që bashkë me mua firmos, i bashkëngjitet këtij akti nën gërmën "A".

Duke qenë se nuk ka asgjë tjetër për të vendosur dhe asnjë tjetër nuk e kërkon fjalën, Kryetari e deklaron të mbyllur asamblenë në orën 11,20 (njëmbëdhjetë e njëzet minuta)

Ky akt pjesërisht i daktilografuar në bazë të ligjit nga një person i besuar i imi dhe pjesërisht i shkruar me dorë nga unë noteri në një fletë nga e cila janë znënë tre faqe përveç kësaj, i lexohet nga unë të paraqiturit, i cili e deklaron në përputhje me vullnetin e tij dhe nënshkruhet në orën 11.30 (njëmbëdhjetë e tridhjetë minuta).

Firmosur: ROBERTO ARDUINI

Vincenzo Galeota Noter

SHTOJCA "A" E AKTIT TIM

Nr. 128156 Rep. Nr. 29896 Koll.

STATUTI I "SERVIZI GEOTECNICI" – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

KAPITULLI I: EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA – OBJEKTI

Neni 1) EMËRTIMI – është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "SERVIZI GEOTECNICI" – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.





Neni 2) SELIA: - 1. Shoqëria e ka selinë ligjore në Komunën L'Aquila në adresën që rezulton nga rregjistrimi pranë Zyrës Kompetente të Rregjistrimit të Ndërmarrjeve në bazë të nenit 111-ter të dispozitave zbatuese të kodit civil.

Selia administrative ndodhet pranë selisë së shoqërisë.

2. Me vendim të organit administrativ shoqëria mund të transferojë selinë e shoqërisë në kuadër të vetë komunës, të hapë dhe të mbyllë degë, agjensi, zyra dhe përfaqësi edhe gjetkë, ndërsa për hapjen e selive dytësore është i nevojshëm vendimi i ortakëve.

Neni 3) – KOHËZGJTJA – Kohëzgjatja e Shoqërisë caktohet deri në 31 dhjetor 2040 por mund të shtyhet ose priset paraprakisht me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4) – OBJEKTI – Shoqëria ka për objekt aktivitetet e mëposhtme:

- Dhënia e studimeve, shërbimeve, programimeve, projekteve dhe drejtimit të punimeve në fushën e inxhinierit civil, të gjeologjisë dhe të gjeoteknikës. Në veçanti bën dhe koordinon kërkimet gjeologjike dhe gjeoteknike në vend dhe në laborator, merret me drejtimin dhe administrimin e laboratorëve të kantierit nëpërmjet ekzekutimit të kërkimeve specifike, marrjes së mostrave, kontrollet dhe testimet për materialet (toka, beton, çelik, konglomerate bituminoze, etj.) dhe për strukturat dhe materialet e ndërtimit.

- Ekzekutim të shpimeve horizontale dhe vertikale me diametr të vogël dhe të madh, ekzekutim i shtyllave të vogla dhe të shtyllave në përgjithësi, të tërheqësve, injektive, konsolidime dhe vepra të lidhura si edhe çdo lloj ndërhyrje të posaçme në nëntokë në përgjithësi. Këto aktivitete bëhen me anë të pajisjeve të veta ose të të tretëve. Gjithashtu dhënie shërbimesh dhe konsulencash për ndërmarrjet në kuadër të programimit dhe të administrimit të porosive dhe tenderave si publike ashtu edhe private (kontabiliteti industrial).

Gjithashtu shoqëria mund të organizojë dhe administrojë labore dhe struktura për bërjen e kolaudimeve dhe analizave teknike të produkteve dhe strukturave dhe materialeve të ndërtimit dhe në veçanti, thjesht si shembull, të bëjë aktivitete në lidhje me kolaudimet fizike, kimike ose të ndonjë lloji tjetër për materialet dhe produktet, ndër të cilat: provat e akustikës dhe të vibracioneve, testimet për përbërjen dhe pastërtinë e mineraleve dhe të materialeve të tjerë, analiza të karakteristikave, të vetive fizike dhe të shërbimeve të materialeve, si rezistenca, trashësia, kohëzgjatja, radioaktiviteti etj, provat e kualifikimit dhe të besueshmërisë testimet e shërbimeve të makinerive të gatshme: motorëve, automobilave dhe pajisjeve elektronike, analizat radiografike të saldimit dhe të bashkimeve, analizat e difekteve, analizat dhe matjet e treguesve ambientale: ndotësve atmosferikë dhe hidrikë, testimet e bëra me anë të përdorimit të modeleve (shembull; avionët, anijet, digat), dhe aktivitetet e suportit të laboratorëve të policisë shkencore;

Shoqëria mund të bëjë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, duke përjashtuar grumbullimin e kursimit mes publikut – mobiluar dhe imobiluar, që konsiderohen nga organi administrativ të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, sidoqoftë duke saktësuar që aktiviteti financiar mund të bëhet vetëm me qëllim për të realizuar objektin e shoqërisë. Gjithashtu ajo mund të marrë kuota në ndërmarrje dhe konsorciume me qëllime të ngjashme dhe të afërta, mjafton që këto marrje të bëhen në masë jo mbizotëruese, por vetëm me qëllim për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Për arritjen më të

mirë të qëllimit të shoqërisë, por sidogoftë në nënvartësi dhe jo eskuzive as mbizotëruese, shoqëria mund të japë dhe të marrë fidejusione, garanci, sidogoftë duke përjashtuar sa parashikohet nga neni 2474 kod. Civil. Megjithatë shoqërisë i ndalohet si ushtrimet profesionale ndaj publikur të shërbimeve të investimeve dhe të ndërmjetësimit financiar sipas nenit 1 të d. legjislativ 24 shkurt 1998, nr. 58, ashtu edhe ushtrimi ose ndaj publikut ose në rrugë mbizotëruese të aktiviteteve sipas nenit 106, pika 1, e d. legjislativ 1 shtator 1993, nr. 385-. Së fundi i ndalohet shoqërisë kryerja e aktiviteteve sipas ligjit 23 nëntor 1939, nr. 1966, si edhe zhvillimi i çdo lloj aktiviteti për të cilat nevojiten kërkesa ose autorizime të veçanta, deri sa këto kërkesa ose autorizime nuk arrihen. Sidogoftë shoqërisë i ndalohet shprehimisht bërja e funksioneve që i rezervohen në mënyrë eskuzive nga ligji të rregjistruarve të urdhrat profesionale dhe për këtë duhet të shfrytëzojë shërbimet e profesionistëve të lejuar dhe të rregjistruar në urdhrat e posaçëm, në se është e nevojshme për shërbimet e lartpërmendura.

Neni 5) **VENDBANIMI I ORTAKËVE** – 1. Vendbanimi i ortakëve, për të gjitha raportet me shoqërinë, është ajo që rezulton nga libri i ortakëve.

2. Është detyrim i ortakëve t'i komunikojë shoqërisë, për qëllimet e transkriptimit në librin e ortakëve, edhe numri i telefaksit dhe adresa e.mail. Në defekt nuk do të jetë e mundur përdorimi ndaj ortakut të këtyre formave të komunikimit.

#### **KAPITULLI II: KAPITALI – KUOTAT – TITUJT E DEBISË**

Neni 6) – **KAPITALI** . 1. Kapitali themeltar është prej 10,200,00 (dhjetëmijë e dyqind presje zero) EURO, dhe është i ndarë në kuota edhe me shumë të ndryshme në bazë të ligjit.

2. Kapitali themeltar mund të rritet me vendim të asamblesë së ortakëve. Aplikohen dispozitat sipas neneve 2481 – 2481 bis – 2481 ter të kodit Civil.

3. Me përjashtim për rastit sipas nenit 2482 -ter të kodit civil, shtimi i kapitalit mund të bëhet edhe me anë të ofertës së kuotave me emetim të ri të tretëve; në këtë rast ortakëve që nuk kanë pranuar vendimin i takon e drejta e tërheqjes.

4. Në rast ulje të kapitalit më shumë se një e treta për humbje, fotokopja e relacionit të administratorëve për bilancin e shoqërisë, me vërejtjet e mundshme të Ekspertit Kontabël të Vetëm ose të revizorit, nëse ka të emëruar, nuk duhet të qëndrojë e depozituar në selinë e shoqërisë për të paktën tetë ditë përpara asamblesë, por do të lexohet dhe ilustruhet, ndoshta me vërejtjet e Ekspertit Kontabël të Vetëm ose të revizorit, nëse ka të emëruar, gjatë asamblesë së ortakëve.

Neni 7) **FINANCIMET E ORTAKËVE** – 1. Kreditet që vijnë nga financime të ortakëve për shoqërinë nuk prodhojnë interesa me përjashtim të ndonjë marrëveshje të ndryshme; gjithashtu shoqëria ka të drejtë të grumbullojë kurim mes ortakëve me anë të marrjes së fondeve me detyrim kthimi, gjithshka në respektim të normave ligjore në fuqi (aktualisht nenin 11 i D. Legjislativ nr. 385/1993 dhe vendimin e C.I.C.R. datë 3 mars 1994) dhe për këtë, vetëm nga persona të rregjistruar në librin e ortakëve prej të paktën tre muajsh dhe që mbajnë një kuorë prej të paktën 2% (dy për qind) të kapitalit themeltar që rezulton nga bilanci i fundit i miratuar.

2. Rimbursimi i financimeve të ortakëve në favor të shoqërisë i nënshtrohet kufizimeve sipas nenit 2467 të kodit civil.



NENI 8 – PRURJET – 1. Si në momenti e krijimit të shoqërisë ashtu edhe në rast të rritjes së kapitalit themeltar mund të sillen në shoqëri: para, pasuri në natyrë, kredi, detyrime të ortakëve dhe shërbime pune ose dhënie shërbimesh në favor të shoqërisë; gjithshka në respektim të dispozitave sipas neneve 2464 – 2465 – 2466 të kodit civil.

Neni 9) – KUOTAT – 1. Kuotat e ortakëve mund të jenë me shumë të ndryshme në bazë të ligjit dhe mund të vendosen edhe në masë jo proporcional me prurjet, me përjashtim të dispozitës së pikës së parë të nenit 2464 të Kodit Civil.

2. Me përjashtim të ndonjë marrëveshje të ndryshme, presupozohet që kuotat e ortakëve nuk janë proporcionale me prurjet e bëra.

3. Të drejtat e shoqërisë i takojnë, sipas rregullit, ortakëve në masë proporcionale me kuotat e zotëruara nga secili.

4. Me vendnim të të gjithë ortakëve mund t'i atrobuohen ortakëve të veçantë të drejta në lidhje me administrimin e shoqërisë ose shpërndarjen e fitimeve, thjesht si shembull: e drejta për të administruar shoqërinë derisa të ketë cilësinë e ortakut; të drejtën për emërimin e një ose më shuëm administratorëve; të drejtën për të autorizuar paraprakisht disa operacione; e drejta për të marrë një kuotë fitimesh më shumë në krahasim me kuotën e vet në shoqëri. Këto të drejta janë personale dhe nuk mund të çedohen me kuotën a me akt mes të gjallësh as për shkak vdekje. Mund të ndryshohen vetëm me konsensusin e të gjithë ortakëve.

5. Në asnjë rast shoqëria nuk mund të marrë ose të pranojë në garanci kuotat të vetat, ose të japë hua dhe garanci për blerjen e tyre ose për firmosjen e tyre.

Neni 10) TRANSFERIM MES TË GJALLËVE – PARABLERJA

1. Kuotat e shoqërisë mund të transferohen, të gjitha ose pjesë të tyre, me akt mes të gjallësh ose për shkak vdekje.

2. Kuotat e shoqërisë mund të transferohen lirisht mes ortakëve.

3. Në rast transferimi mes të gjallëve të kuotës, ose të të drejtave të firmosjes sipa nenit 2481 bis, pika 1, e kodit civil, të tretëve jo ortakë, me përjashtim të dhurimeve në linjë të drejtë, do të nevojitet konsensusi paraprak nga ortakët jo çedues, ose eksperimentimi i procedurës së mëposhtme.

4. Ortaku që ka ndër mend të çedojë me akt mes të gjallësh të gjithë ose pjesë të kuotës së vet, ose të drejtat për firmosjen sipas nenit 2481 bis, pika 1, i kodit civil, duhet t'ja komunikojë vendimin e vet të gjithë ortakëve të tjerë, me letër rekomande me njoftim marrje, duke paraqitur; gjeneralitete e blerësit potencial, çmimit e kërkuar dhe vlerën e kuotës ose të të drejtave dhe mënyrat e pagesës,

5. Brenda afatit të dekadencës prej tridhjetë ditësh nga ky njoftim, ortakët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në proporcion me kuotat e zotëruara dhe, gjithmonë, me letër rekomande me njoftim marrje, t'i komunikojnë vendimin e tyre ortakut që ka ndër mend të tjetërsojë.

6. Nëse ndonjë nga ortakët nuk ka ndër mend të ushtrojë të drejtën e parablerjes, kjo e drejtë mund të ushtrohet pro-kuota nga ortakët e tjerë. E drejta e parablerjes mund të ushtrohet vetëm për mallin e tij ose të drejtën objekt i komunikimit nga ana e ortakut tjetërsues.

7. Në rast çedimi të kuotave me shumë të pakëmbyeshme, vlera e vetë kuotave, në mungesë të marrëveshjes, do të përcaktohet në bazë të bilancit të shoqërisë, duke mbajtur parasysh vlerën e saj të tregut, përfshirë nisjen, me anë të një relacioni të betuar të një eksperti të emëruar nga Kryetari i Urdhrit të Ekonomistëve të vendit ku e ka selinë shoqëria; vendimit të ekspertit i aplikohet pika e parë e nenit 1349 të kodit civil. Eksperti merr masta është për shpenzimet që do të ndahen për gjysëm në ngarkim të ortakut shitës dhe gjysma tjetër në ngarkim të ortakëve që ushtrojnë parablerjen, me përjashtim kur vlera e eksperimentit rezulton më e ulët se 20% në krahasim me vlerën e paraqitur nga shitësi, në këtë rast do të jenë në ngarkim eskuziv të ortakut shitës.

8. Është e drejta e shitësit të heqë dorë nga transferimi i kërkuar duke hequr dorë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes, në rast se e mendon të papërshtatshëm vlerën e caktuar nga eksperti.

9. E drejta e parablerjes nuk aplikohet në ras transferimi në favor të shoqërisë fiduciare ose trustit të autorizuar për ushtrimin e këtyre aktiviteteve dhe të ritransferimit nga ana e saj ortakut fiduciar fillestar, me paraqitjen paraprake të mandatit fiduciar.

10. Në rast mosrespektimi të normave të përcaktuara nga ky nen, tjetërsimi nuk do të ketë efikasitet ndaj shoqërisë dhe blerësi nuk mund të rregjistrohet në librin e ortakëve as të ushtrojë të drejtat që vijnë nga cilësia e ortakut.

11. Kuotat mund të jepen si barrë dhe mbi to mund të krijohet e drejta e uzufuktit vetëm me konsensusin e të gjithë ortakëve; në këtë rast ortakut duhet të rezervojë për vete të drejtën e votës; për pjesën tjetër aplikohet neni 2352 i kodit civil.

Neni 11) – TRANSFERIM PËR SHKAK VDEKJE – 1. Në rast vdekje të njërit prej ortakëve, shoqëria, me vendim të ortakëve të marrë me shumicë absolute të kapitalit themeltar, duke mos u llogaritur në korum kuota e ortakut të vdekur, mund të zgjedhë t'ia likuideojë kuotën trashëgimtarëve ose të vazhdojë me ata.

2. Në rast se trashëgimtarët janë më shumë se një, duhet të përfaqësohen nga një përfaqësues i përbashkët, i pëlqyer nga ortakët e mbetur, i emëruar sipas mënyrave të parashikuara nga nenet 1105 dhe 1106 të kodit civil.

3. Rimburimi i kuotave për trashëgimtarët e ortakut të vdekur do të bëhet në afatin dhe me mënyrat e parashikuara nga neni tjetër 14 i këtij statuti.

Neni 12) – TËRHEQJA – 1. I takon ortakëve e drejta e tërheqjes vetëm për çështjet që nuk mund të anashkalohehen sipas neneve 2473 -2481 bis kodi civil.

2. Gjithashtu tërheqja i takon ortakëve, nëse shoqëria i nënshtrohet aktivitetit të drejtimit dhe të koordinimit, në hipotezat e parashikuara nga neni 2497-quater i kodit civil.

3. Tërheqja mund të ushtrohet, ndryshe nuk ka vlerë, me anë të komunikimit me shkrim të dërguar shoqërisë me anë të letrës rekomande me njoftim marrje brenda pesëmbëdhjetë ditësh që duhet të kalojnë në mënyrë alternative:

-nga rregjistrimi në Rregjistrin e ndërmarrjeve të vendimit të asamblesë së ortakëve që e legjitimin, nëse parashikohet;

-në mungesë nga transkriptimi i vendimit në librin e vendimeve të ortakëve;

- të njohjes së marrë nga ana e ortakut tërheqës së faktit që e legjitimon tërheqjen.



4. Komunikimi i tërheqjes duhet të shënohet pa vonesë nën kujdesin e organit administrativ në librin e ortakëve.

5. Tërheqja ka efekt pasi kalojnë tridhjetë ditë nga data në të cilën deklarata e tërheqjes mbërrin në selinë e shoqërisë. Nuk mund të ushtrohet, dhe nëse është ushtruar është pa efikasitet, nëse shoqëria e revokon vendimin që e legjitimon ose nëse është vendosur prishja e shoqërisë.

6. Ortakët që tërhiqen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin rimbursimin e kuotës së vet në proporcion me pasurinë e shoqërisë, në afatin dhe me mënyrat e parashikuara nga neni 14 i mëposhtëm i këtij statuti. Tërheqja nuk mund të ushtrohet për një pjesë të vetme të kuotës.

7. Për rimbursimin e kuotës aplikohen dispozitat sipas nenit 2473, pika 4, e kodit civil.

8. Në konsideratë të kufizimeve të parashikuara nga ky statut për transferimin për shkak vdekje të kuotave, gjithashtu i takon ortakëve dhe trashëgimtarëve të tyre e drejta e tërheqjes, në bazë të nenit 2469, pika 2 e kodit civil, që nuk mund të ushtrohet përpara dy vitesh nga themelimi i shoqërisë ose nga firmosja e kuotës, Neni 13) PËRJASHTIMI – 1. Konsiderohen hipoteza përjashtimi nga shoqëria për shkak të duhur:

- Falimentimi, heqje e të drejtës për ushtrim posti publik ose fshirja nga rregjistrat profesionalë të ortakut, dënimi i tij me një dënim që sjell heqjen e të drejtës edhe të përkohshme nga detyrat publike;

- Ushtrimi nga ana e ortakut, për llogari të vetën ose të të tjerëve, edhe si ortak i një shoqërie fakti, të një aktiviteti konkurrues me atë të shoqërisë, me përjashtim kur ekziston konsensusi me shkrim i të gjithë ortakëve të tjerë.

- Pamundësia përfundimtare nga ana e ortakut për të bërë pagesat (vonesa), shërbimi i punës dhe dhënia e shërbimeve në favor të shoqërisë që përbën objekt të prurjes së vet.

2. Përjashtimi përcaktohet me vendim të ortakëve të marrë me shumicë absolute të kapitalit themeltar, duke mos llogaritur në korum kuotën e ortakut për përjashtimin e të cilit bëhet fjalë, dhe ka efekt pasi kalojnë tridhjetë ditë nga data e komunikimit, me anë të letrës rekomande me njoftim marrje, ortakut të përjashtuar.

3. Brenda këtij afati, ortakut i përjashtuar mund të kundërshtojë përpara arbitrit të vetëm të emëruar me mënyrat sipas nenit të mëposhtëm 32 të këtij statuti; kundërshtimi pezullon ekzekutimin.

4. Nëse shoqëria përbëhet nga dy ortakë, përjashtimi i njërit prej tyre deklarohet nga arbitri i vetëm, me kërkesë të tjetrit.

5. Ortakët e përjashtuar kanë të drejtë të marrin rimbursimin e kuotës së vet në proporcion me kapitalin e shoqërisë, në afatin dhe me mënyrat e parashikuara nga neni 14 i mëposhtëm i këtij statuti.

6. Në rast se rimbursimi i kuotës nuk është i mundur as nëpërmjet blerjes së saj nga ana e ortakëve të tjerë ose nga ana e një të treti të gjetur bashkarisht nga vetë ortakët, rimbursimi bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme. Në mungesë përjashtimi nuk mund të bëhet.

Neni 14) RIMBURSIMI I KUOTËS- 1. Në rast vdekje (me likuidkim të kuotës trashëgimtarëve), tërheqja ose përjashtimi i një ortakut, përkatësisht trashëgimtarët e ortakut të vdekur dhe ortakut i tërhequr ose i përjashtuar kanë të drejtë të marrin rimbursim të kuotës.

2. Rimbursimi i kuotës atyre që kanë të drejta do të bëhet brenda 180 ditësh nga vdekja ose nga komunikimi ortakut të tërheqjes ose të përjashtimit dhe mund të bëhet me anë të blerjes së kuotës nga ana e të gjithë

ose të disa prej ortakëve të tjerë në proporcion me kuotën e tyre ose nga ana e një të treti të gjetur bashkarisht nga vetë ortakët.

3. Vlera e kuotës përcaktohet nga organi administrativ mbi bazën e bilancit të shoqërisë në momentin e vdekjes ose të komunikimit të tërhejes ose të përjashtimit, duke mbajtur parasysh vlerën e saj të tregut përfshirë nisjen; në rast mosmarrëveshje me anë të relacionit të betuar të një eksperti të emëruar nga Kryetari i Urdhrit të Ekonomistëve të vendit ku e ka selinë shoqëria; vendimit të ekspertit i aplikohet pika e parë e nenit 1349 të kodit civil. Eksperti merr masat edhe për shpenzimet që do të ndahen për gjysëm në ngarkim të shoqërisë ose të ortakëve që ushtrojnë të drejtën ose nga një i tretë blerës dhe për gjysmën tjetër në ngarkim të trashëgimtarëve të ortakut të vdekur ose të ortakut të tërhequr ose të përjashtuar, me përjashtim kur vlera e ekspertimit rezulton më e madhe se 20% në krahasim me vlerën e paraqitur nga shoqëria, në këtë rast do të jenë në ngarkim eskuziv të saj.

4. Në të gjitha rastet e rimbursimit të kuotës së një ortaku nga ana e shoqërisë, rritet në proporcion vlera e kuotave të ortakëve të tjerë.

Neni 15) TITUJT E DEBISË – 1. Shoqëria mund të emetojë tituj debie, në respektim të parashikimeve të nenit 2483 të kodit civil, me vendim të asamblesë së marrë me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e kapitalit të shoqërisë, të verbalizuar nga një noter dhe të rregjistruar në Rregjistrin e Ndërmarrjeve.

2. Vendimi i emetimit të titujve parashikon kushtet e huasë, mënyrat e rimbursimit dhe ndryshimet e mëpasshme të këtyre kushteve.

### KAPITULLI III - VENDIMET E ORTAKËVE

Neni 16) KOMPETENCA – I rezervohen kompetencës së ortakëve:

a) Miratimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimeve, me përjashtim të të drejtave të mundshme për fitime që u takojnë ortakëve të veçantë, në bazë të nenit 2468, pika 3, e kodit civil;

b) Emërimin e administratorëve, me përjashtim të të drejtave të mundshme të emërimit që i takojnë ortakëve të veçantë në bazë të nenit 2468, pika 3 e kodit civil;

c) Emërimin e Ekspertit Kontabël të Vetëm ose të revizorit në rastet e parashikuara nga neni 2477 i kodit civil;

d) Përcaktimi i kompensimit të administratorëve, të ekspertit kontabël të miratuar dhe të revizorit, nëse nuk është përcaktuar në aktin e themelimit;

e) Ndryshimet e aktit të themelimit dhe të statutit;

f) Vendimi për të bërë operacione që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë të përcaktuar në aktin e themelimit ose një ndryshim të rëndësishëm të të drejtave të ortakëve.

g) Prishja e shoqërisë, caktimi i numrit të likuidatorëve, emërimi i tyre dhe të drejtat e tyre;

h) Emetimi i titujve të debisë;

i) Përjashtimi i një ortaku;

j) Çështjet e tjera që i rezervohen kompetencës së tyre me ligj, nga akti i themelimit, nga ky statut ose që i nënshtrohen miratimit të tyre nga një ose më shumë administratorë ose nga aq ortakë sa përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar.



Neni 17) FORMIMI I VENDIMEVE TË ORTAKËVE – 1. Vendimet e ortakët mund të merren:

- a) Me metodën e asamblesë;
- b) Me anë të konsultimit me shkrim;
- c) Mbi bazën e konsensusit të shprehur me shkrim.

2. Me referim çështjeve të paraqitura në gërmat e, f), g), h) të nenit 16 të mësipërm të këtij statuti ose kur e kërkojnë të paktën një e treta e kapitalit të shoqërisë vendimet e ortakëve duhet të merren me vendim asambleje.

Neni 18) ASAMBLEJA – THIRRJET – 1. Asambleja thirret nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Këshillit Administrativ me anë të letrës rekomande me njoftim marrje, që i dërgohet ortakëve, në vendbanimin që rezultojnë në librin e ortakëve, dhe ekspertëve kontabël të miratuar dhe revizorit, nëse ka të emëruar, të paktën tetë ditë përpara mbledhjes. Mund të thirret edhe me telefaks ose me e-mail që duhet t'i dërgohet ortakëve, përkatësisht në numrin ose në adresën që rezulton nga libri i ortakëve, dhe ekspertëve kontabël të miratuar dhe revizorit, nëse ka të emëruar, të paktën pesë ditë përpara mbledhjes, I lejohet çdo ortaku, që mban të paktën 20% të kapitalit themeltar, të kërkojë thirrjen e asamblesë me kërkesë me shkrim që përmban argumentat që do të trajtohen.

2. Në njoftimin e thirrjes duhet të paraqitet vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve që do të trajtohen.

3. Asambleja mund të thirret kudo, edhe jashtë selisë së shoqërisë, mjafton që të jetë në territorin kombëtar.

4. Në mungesë të thirrjes së rregullt, asambleja thirret në mënyrë të vlefshme në formë totalitare kur në të merr pjesë i gjithë kapitali i shoqërisë dhe të gjithë administratorët, ekspertët kontabël të miratuar dhe revizorët, nëse ka të emëruar, janë të pranishëm ose të informuar për mbledhjen dhe asnjë nuk kundërshton trajtimin e argumentit. Për qëllimet e verifikimit të vlefshmërisë së asamblesë totalitare, administratorët, ekspertët kontabël të miratuar dhe revizori, ndoshta që mungojnë, duhet të bëjnë një deklaratë me shkrim se janë informuar me të shpejtë për mbledhjen dhe se nuk kanë kundërshtim për trajtimin e argumentave, dhe kjo deklaratë do të ruhet mes akteve të shoqërisë.

5. Asambleja për miratimin e bilancit duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda njëqind e njëzet ditësh nga mbyllja e ushtrimit të shoqërisë; bën përjashtim thirrja brenda një afati më të madh në kufijtë dhe me kushtet e parahikuara nga pika e dytë e nenit 2364 të kodit civil.

E DREJTA E MARRJES PJESE. 6. Mund të marrin pjesë në asamble të gjithë ata që rezultojnë të rregjistruar në librin e ortakëve.

7. Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet, me prokurë me shkrim, eskuzivisht nga një ortak tjetër. Prokurat ruhen nga shoqëria.

8. I takon kryetarit të asamblesë të konstatojë të drejtën për të marrë pjesë në asamble.

E DREJTA E VOTËS. 9- Çdo ortak ka të drejtë vote dhe vota e tij vlen në masë proporcionale me kuotën e tij.

10. Ortaku në vonesë në derdhjet, në bazë të nenit 2466 të kodit civil, nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës.

DREJTIMI I ASAMBLESE. 11. Asambleja drejtohet nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Këshillit Administrativ; në mungesë Asambleja cakton Kryetarin e vet me shumicë absolute. Me të njëjtën shumicë Asambleja emëron edhe një sekretar, edhe jo ortak, dhe zgjedh mes ortakëve edhe dy numërues votash, nëse është e nevojshme.

12. Kryetari i asamblesë verifikon rregullsinë e mbledhjes, vërteton identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e saj dhe vërteton rezultatet e votimeve.

THIRRJA E ASAMBLESE. 13. Asambleja vendos me votën pro të aq ortakëve që përfaqëson shumicën e kapitalit themeltar, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga gërmat e), f), g), h) të nenit të mëparshme 16) në të cilat nevojitet vota pro e aq ortakëve që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e kapitalit themeltar.

14. Bëjnë përjashtim shumicë të ndryshme dhe më të mëdha të mundshme të kërkuara në mënyrë të pashmangshme nga ligji dhe nga ky statut.

15. Vendimet merren me ngritje dore përveç kur shumicë kërkon apelin me emër. Sidoqoftë nuk mund të merret votë e fshehtë.

16. Vendimet, e marra në përputhje me ligjin dhe me statutin e shoqërisë, detyrojnë të gjithë ortakët edhe nëse mungojnë ose nuk janë dakord.

VERBALIZIMI. 17. Vendimet e Asamblesë duhet të rezultojnë në proces verbalin e firmosur nga kryetari dhe nga sekretari ose nga noteri.

18. Proces verbali duhet të përmbajë datën e asamblesë dhe, edhe bashkëngjitur, identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin e përfaqësuar nga secili; gjithashtu duhet të tregojë mënyrat dhe rezultatit e votimit dhe duhet të japë mundësi, edhe bashkëngjitur, identifikimin e ortakëve që kanë votuar pro, të abstenuar ose që kanë votuar kundër. Në proces verbal duhet të përmbledhen, me kërkesë të ortakëve, deklaratimet e tyre në lidhje me rendin e ditës.

19. Proces verbali i asamblesë që ka për objekt çështjet sipas gërmave e), f), g), h) të nejit të mësipërm 16 duhet të hartohet nga një noter.

Neni 19) KONSULTIM ME SHKRIM – KONSENSUSI I SHPREHUR ME SHKRIM – 1. Për “konsultim me shkrim” nënkuptohet procedimi i nisur nga një ose më shumë ortakë ose nga një ose më shumë administratorë me të cilën i propozohet ortakëve, me komunikim me shkrim në çdo lloj suporti, të firmosur edhe me firmë dixhitale dhe të dërguar me çdo mjet që jep mundësi që të kihet marrje edhe nga të gjithë ortakët e tjerë dhe administratorët, ekspertët kontabël të miratuar ose revizorët, nëse ka të emëruar, një vendim të caktuar që rezulton qartësisht nga dokumenti i dërguar. Përgjigja e ortakëve për konsultimin duhet të vendoset në fund të propozimit me diçiturën “pro” ose “kundër”, vërejtjet e mundshme në mbështetje të votës së shprehur, datën dhe firmën edhe me firmë dixhitale.

2. Vendimi nënkuptohet i marrë nëse vijnë pranë selisë së shoqërisë, brenda tridhjetë ditësh nga dërgimi i propozimit të vendimit, votat pro të aq ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit themeltar, me përjashtim të shumicave më të mëdha të kërkuara nga ky statut.

3. Mos përgjigja ndaj propozimit të vendimit vlen si një votë kundër.

4. Data e vendimit është ai kur mbërrin pranë selisë së shoqërisë vota e fundit pro e nevojshme për miratimin e vendimit.

5. Me "konsensus të shprehur me shkrim" nënkuptohet konsensusin i aq ortakëve sa përfaqësojnë shumicën e kapitalit themeltar (me përjashtim të shumicave më të mëdha të kërkuara nga ky statut) në një tekst vendimi të formuluar qartësisht me shkrim në çdo lloj suporti Vota e ortakëve vendoset në fund të tekstit të vendimit me dikturën "pro" ose "kundër", vërejtjet e mundshme në mbështetje të votës së shprehur, datën dhe firmosjen edhe me firmë dixhitale.

6. Data e vendimit është ajo në të cilën depozitohet në selinë e shoqërisë dokumenti me shkrim që përmban tekstin e vendimit dhe votat e favorshme të nevojshme për miratimin e tij.

7. çdo ortak i regjistruar në librin e ortakëve, që nuk është me vonesë në pagesa ndaj shoqërisë, në bazë të nenit 2466 të kodit civil, ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e parashikuara nga neni 16 i statutit të shoqërisë dhe vota e tij vlen në masë proporcionale me kuotën e tij.

8. Organi administrativ, pasi verifikon që vendimi i ortakëve është marrë në mënyrë të vlefshme në një nga mënyrat e përshkruara më sipër, duhet t'i japë komunikim të shpejtë të gjithë ortakëve, administratorëve dhe ekspertëve kontabël të miratuar ose revizorëve, nëse ka të emëruar, dhe duhet të transkriptojë pa vonesë vendimin në librin e vendimeve të ortakëve.

9. Të gjitha dokumentat e procedimit të konsultimit me shkrim dhe dokumenti nga i cili rezulton konsensusi i shprehur me shkrim duhet të ruhen nga shoqëria.

#### KAPITULLI IV) ADMINISTRIMI

Neni 20) ORGANI ADMINISTRATIV – 1. Shoqëria administrohet në mënyrë alternative:

- Nga një Administrator u Vetëm;

- nga më shumë administratorë që veprojnë në formën e Këshillit Administrativ ose me fuqi për të administruar veç e veç ose bashkarisht me mënyrat sipas neneve 2257 dhe 2258 të kodit civil.

2. Nëse administrimi i takon veç e veç më shumë ortakëve, secili ortak administrator ka të drejtë të kundërshtojë operacionin që një tjetër kërkon të bëjë, përpara se të bëhet. Shumica e ortakëve, e vendosur sipas pjesës që i atribuohet secilit ortak në fitime, vendos për kundërshtimin.

3. Sidoqoftë, hartimi i projektit të bilancit dhe i projekteve të shkrirjes dhe ndarjes, si edhe vendimet e shtimit të kapitalit themeltar që mund t'i jenë dhënë administratorëve në bazë të nenit 2481 të kodit civil, janë në kompetencë të Këshillit Administrativ.

4. Me vendim emërimi të administratorëve, ortakët përcaktojnë: numrin e tyre, strukturën e organit administrativ dhe kufizimet e mundshme të fuqive administruese që i atribuohen njëkohësisht kompetencës së vendimit të ortakëve. Në rast se në vendimin e emërimit nuk është përcaktuar ndryshe, administratorët krijojnë Këshillin Administrativ.

3. Anëtarët e organit administrativ mund të zgjidhen edhe mes jo ortakëve dhe qëndrojnë në detyrë me afat të pacaktuar deri në dorëheqje ose revokim nga ana e ortakëve (edhe pa ndonjë shkak të justifikuar) ose përsa kohë që përcatohet dhera herës në aktin e emërimit. Në rast të emërimit me afat kohor të pacaktuar, revokimi i administratorëve, edhe pa shkak të justifikuar, nuk do t'i japë atyre asnjë të drejtë për dëmshpërblim.

6. Administratorët mund të rizgjidhen.

7. Nuk mund të emërohen administratorë, dhe nëse janë emërua bien nga detyra e tyre, ata që ndodhen në kushtet sipas nenit 2382 të Kodit civil.

8. Nëse do të mungojnë një ose më shumë administratorë, ata që kanë mbetur në detyrë duhet t'i propozojnë ortakëve të marrin vendimin për emërimin e administratorëve të rinj, të cilëve do t'u mbarojë afati bashkë me ata në detyrë në aktin e emërimit të tyre.

Neni 21) FUQITË: 1. Organi administrativ, në përputhje me strukturën e tij të përcaktuar nga ortakët me vendimin e emërimit, i ka fuqitë nga më të gjerat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtë të bëjë të gjitha aktet që i mendon si të nevojshme për arritjen e objektivit të shoqërisë që me ligj, me akt themelimi dhe me statut nuk i janë atribuar kompetencës eskuzive të vendimit të ortakëve.

2. Organi administrativ, me prokurë, mund të emërojë përfaqësues të shoqërisë për akte ose kategori të caktuara aktesh.

Neni 22) KËSHILLI ADMINISTRATIV: 1. Këshilli Administrativ zgjedh mes anëtarëve të vet një Kryetar dhe, nëse është rasti, një Zëvendës kryetar, përveç kur kanë marrë masat vetë ortakët në aktin e emërimit të vetë Këshillit.

2. Këshilli mbledhet në vendin e paraqitur në njoftimin e thirrjes sa herë që Kryetari e gjykon të nevojshëm dhe kur është bërë kërkesë me shkrim nga të paktën gjysma e anëtarëve ose nga ekspertët kontabël të miratuar ose nga revizori, nëse ka të emëruar.

3. Njoftimi i thirrjes bëhet me letër rekomande me njoftim marrje të paktën tetë ditë përpara, dhe në rast urgjence me telefaks ose me e-mail që duhet t'i dëgohet të paktën dy ditë përpara, nga data e caktuar për mbledhjen secilit anëtar të Këshillit dhe ekspertëve kontabël të miratuar ose revizorit, nëse ka të emëruar.

4. Mbledhja e Këshillit është e vlefshme, edhe në mungesë të thirrjes së rregullt, në rast se janë të pranishëm të gjithë këshilltarët në detyrë dhe ekspertët kontabël të miratuar ose revizori, nëse janë të emëruar.

5. Mbledhjet e Këshilli drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë të tillë, nëse ekziston, nga zëvendës kryetari ose nga këshilltari i deleguar. Në mungesë, drejtohen nga Këshilltari më i vjetër në moshë.

6. Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit është e nevojshme prania e shumicës së Administratorëve në detyrë. Vendimet merren me shumicë të votave të të pranishmëve.

7. Vendimet e Këshillit Administrativ mund të merren edhe me anë të konsultimit me shkrim ose mbi bazën e konsensusit të shprehur me shkrim. Për këto mënyra marrje vendimesh i bëhet referim sa është vendosur nga neni 19, pikat nga 2 deri në 9 të këtij statuti, me saktësimet e mëposhtme:

- çdo referim personit të ortakëve këtu nënkuptohet administratorëve;
- për marrjen e vendimit të administratorëve është e nevojshme vota pro e shumicës së tyre;
- vendimet duhet të transkriptohen pa vonesë në librin e vendimeve të administratoëve.

8. Këshilli mund t'i delegojë njërit ose më shumë anëtarëve pjesë të fuqive të veta, përfshirë përdorimin e firmës së shoqërisë, duke i caktuar atributet, shpërblimet dhe garancitë e mundshme.

9. Detyra e Kryetarit të Këshillit Administrativ dhe ajo e Administratorit të Deleguar nuk janë të përputhshme mes tyre.



Neni 23) PËRFAQËSIMI LIGJOR – 1. Firma dhe përfaqësimi ligjor i shoqërisë përballë të tretëve dhe në gjykim i takojnë Administratorit të vetëm, të gjithë anëtarëve të Këshillit Administrativ, administratorëve veç e veç ose bashkarisht me Kryetarin e Këshillit Administrativ dhe administratorit të deleguar në kufizimet e prokurës së marrë, sipas vendimeve në momentin e emërimit, me të njëjtat mënyra dhe kufizime me të cilat u jepet atyre fuqia për të administruar shoqërinë.

2. Kufizimet e tagrave të administratorëve që rezultojnë nga akti i themelimit ose nga akti i emërimit, edhe nëse janë të publikuara, nuk i kundërvihen të tretëve, me përjashtim kur provohet që këta qëllimisht kanë vepruar në dëm të shoqërisë.

Neni 24) RIMBURSIMI I SHPENZIMEVE – 1. Administratorëve i takon rimbursimi i shpenzimeve të bëra për arsye të detyrës së tyre.

2. Për detyrat e lartpërmendura ortakët mund të vendosin një shpërblim vjetor si edhe një shpërblim për pushimin e raportit që mund të garantohet edhe me anë të lidhjes së një police të përshtatshme sigurimi.

#### KAPITULLI V: KONTROLLET

Neni 25) EKSPERTI KONTABËL I MIRATUAR – 1. Emërimi i një Eksperti të Vetëm Kontabël të Miratuar, me vendim të ortakëve në bazë të nenit 16 të këtij statuti, nuk është i detyrueshëm, deri sa të ekzistojnë kushtet sipas nenit 24777 të kodit civil.

2. Eksperti i Vetëm Kontabël i Miratuar zgjidhet mes të rregjistruarve në Regjistrin e Revizorëve kontabël të krijuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

3. Eksperti i Vetëm Kontabël i Miratuar qëndron në detyrë për tre ushtrime meskadencë në datën e vendimit të ortakëve që miraton bilancin në lidhje me ushtrimin e tretë të detyrës dhe mund të rizgjidhet. Mund të revokohet vetëm për shkak të drejtë; vendimi i revokimit duhet të miratohet me vendim të gjykatës, pasi dëgjohet i interesuari.

4. Eksperti i Vetëm Kontabël i Miratuar ka detyrime dhe fuqitë e parashikuara nga nenit 2403 dhe në vazhdim të kodit civil dhe ushtron kontrollin kontabël me funksionet e përcaktuara nga neni 2409-ter i kodit civil.

Neni 26) REVIZORI -1. Me vendim të ortakëve mund të emërohet një revizor i rregjistruar në regjistrin e revizorëve kontabël të mbajtur pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Revizori qëndron në detyrë për tre ushtrime me skadencë në datën e vendimit të ortakëve që miraton bilancin në lidhje me ushtrimin e tretë të detyrës dhe mund të rizgjidhet; bie nga detyra në momentin e rregjistrimit në Regjistrin e Ndërmarrjeve të emërimit të Ekspertit të Vetëm Kontabël të Miratuar.

3. Revizori ka të njëjtat funksione dhe të njëjtat detyra dhe tagra të Ekspertit të Vetëm Kontabël të Miratuar.

Neni 27) KONTROLLI I ORTAKËVE – 1. Ortakët që nuk marrin pjesë në administrim kanë të drejtë të kenë nga administratorët njoftime për zhvillimin e bizneseve të shoqërisë dhe të konsultojnë, edhe me anë të profesionistëve të tyre të besuar, librat e shoqërisë dhe dokumentat në lidhje me administrimin.

2. Çdo ortak mund të ngrerë padi për përgjegjësinë kundër administratorëve.

#### KAPITULLI VI: BILANCI DHE FITIMET

Neni 28) USHTRIMET E SHOQËRISË – 1. Ushtrimet e shoqërisë mbyllen në 31 dhjetor të çdo viti.

2. Në përfundim të çdo ushtrimi organi administrativ proçedon me përgatitjen e bilancit të shoqërisë në bazë të ligjit.

3. Bilanci duhet t'i paraqitet ortakëve brenda afatit prej njëqind e njëzet ditësh nga mbyllja e ushtrimit të shoqërisë, me përjashtim të mundësisë për një afat më të madh në kufizimet dhe me kushtet e parashikuara nga pika e dytë e nenit 2364 të kodit civil.

Neni 29) FITIMET – Fitimet neto, pasi zbritet shuma më pak se pesë për qind për rezervën ligjore, deri sa kjo të ketë arritur në kufirin e përcaktuar nga ligji, i atribuohen kapitalit, me përjashtim kur me vendim të ortakëve vendosen marrje të posaçme në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për një destinacion tjetër ose vendoset për t'i dërguar të gjitha ose një pjesë të tyre për ushtrimet në vazhdim, dhe gjithashtu me përjashtim të të drejtave të mundshme për fitimet që i takojnë çdo ortakë në bazë të nenit 2468, pika 3, e Kodit Civil.

#### KAPITULLI VII: PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 30) PRISHJA – 1. Shoqëria prishet me vendim të asamblesë së ortakëve, të marrë me votën pro të aq ortakëve sa përfaqësojnë të paktën dy t tretet e kapitalit të shoqërisë, dhe për shkaqe të tjera prishje të parashikuara nga neni 2484 i kodit civil.

2. Me verifikimin e një shkakut prishje, asambleja e ortakëve, me të njëjtën shumicë sipas pikës së mësipërme, vendos për: numrin e likuidatorëve dhe rregullat e funksionimit të kolegjit në rast kur ka shumë likuidatorë; emërimin e likuidatorëve, me paraqitjen e atyre që u takon përfaqësimi i shoqërisë; kriteret në bazë të të cilave duhet të bëhet likuidimi; tagrat e likuidatorëve, me kujdes të veçantë për shitjen e ndërmarrjes, të degëve të saj ose edhe të pasurive apo të dretave ose bllokimeve të veçanta të tyre; aktet e nevojshme për ruajtjen e vlerës së ndërmarrjes, përfshirë këtu ushtrimin e tij provizor, edhe të degëve të veçanta, në funksion të realizimit më të mirë.

3. Asambleja mund të ndryshojë gjithmonë, me të njëjtën shumicë si të pikës së parë, vendimet sipas pikës së mësipërme.

Neni 31) LIKUIDIMI: - 1. Në fazën e likuidimit të shoqërisë aplikohen dispozitat e neneve 2484 dhe në vazhdim të kodit civil.

2. Emërtimit të shoqërisë duhet t'i shtohen paraqitja që bëhet fjalë për shoqëri në likuidim.

3. Në çdo moment shoqëria mund të revokojë gjendjen e likuiditetit, duke qenë nevoja për eliminimin paraprak të shkakut të prishjes, me vendim të asamblesë së ortakëve, të marrë me të njëjtën shumicë sipas pikës së parë të nenit të mësipërm, me efektet sipas nenit 2487-ter të kodit civil.

#### KAPITULLI VIII: KLAUZOLA KOMPROMISI

Neni 32) ARBITRI – 1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin mes ortakëve si edhe mes shoqërisë në lidhje me raportin në shoqëri ose me interpretimin dhe ekzekutimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërish të marra nga organet e shoqërisë, ato të ngritura nga administratorët, likuidatorët dhe ekspertët kontabë ose ndaj tyre, do t'i jepen një Arbitri të Vetëm të emëruar nga Kryetari i gjykatës së Rrethit në të cilin e ka selinë shoqëria.

2. Nuk mund të jenë objekt i klauzolës së kompromisit mosmarrëveshjet në të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të prokurorit.



3. Arbitri do të vendosë me barazi dhe pa formalitetet dhe gjykimi i tij do të jetë i pa apelueshëm, me përjashtim të sa është parashikuar nga D. legjislativ 17 janar 2003, nr. 5 dhe ndryshimet dhe plotësimet e mundshme.

#### KAPITULLI IX: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 33) KOMUNIKIMET: Komunikimet që duhet të bëhen me letër rekomande me njoftim marrje mund të bëhen në formë ekuivalente, edhe me anë të letrës rekomande të dorëzuar dorazi ortakëve, administratorëve, ekspertëve kontabël, revizorit dhe likuidatorit dhe të frmosur në fund nga ata që e kanë marrë.

Neni 34) REFERIME – Përsa nuk është deklaruar shprehimisht në këtë statut, i bëhet referim dispozitave të kodit civil dhe të ligjeve të tjera në fuqi në këtë fushë.

Firmosur: ROBERTO ARDUINI

Vincenzo Galeota Noter

Regjistruar në datë 04.11.2016 në nr. 4252

Përbëhet nga 18 fletë

L'Aquila më 04.11.2016

GALEOTA VINCENZO – NOTER

(firma, vula e noterit)

#### Apostile

(Konventa e Hages me 5 Tetor 1961)

1. Shteti: Itali

Ky akt publik

2. është firmosur nga Vincenzo Galeota

3. ne cilesine e tij si noter

4. mban vulen e Galeota Vincenzo Fu Carlo noter ne L'Aquila me stampe

#### Vertetim

5. ne L'Aquila 6. Me 26 Qershor 2017

7. Nga Zv.Prokurori i Republikes Dok. Roberta D'Avolio

8. Me nr. 202/17

9. Vule (vula)

10. Firma Zv. Prokurori i Republikes Dok.Roberta D'Avolio (Emer,

Mbiemer, Firme)

Përktheu: ANILA BERBERI



Republika e Shqiperise

Dhoma e Notereve Tirane

Nr 2337 Rep



Date 29.06.2017

**VERTETIM**

Vertetohet nenshkrimi i perkthyeses **Zj.Anila Berberi** e bija e Petritit, dtl. 15.08.1972, lindur ne Bilisht-Korçe dhe banuese ne Tirane, mbajtese e kartes se identitetit nr. H25815062P, me NIPT-L21815002P. Ajo deklaroi se perkthu materialin bashkengjitur me perpikmeri nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe dhe nenshkroi ne baze te ligjit dhe rregullisht perpara meje.



Notere

Ardjana A.Mediu